



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI EKONOMIK**

Rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 221 895 • E-mail: ekonomiku@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

**PROGRAMI PËR STUDIME TË DOKTORATËS NË
SHKENCAT EKONOMIKE**

Prishtinë, shtator 2011

Arsyeshmëria

Që nga viti akademik 2005 – 2006, në Fakultetin Ekonomik nuk është paraqitur asnjë temë e doktoratës. Kjo padyshim është rezultat i ndryshimit të sistemit të doktoratave dhe vonesave për të filluar me sistemin e ri të studimeve të doktoratës që mund të ketë pasoja negative në radhë të parë në ngritjen e kuadrit akademik dhe shkencor të angazhuar dhe që mund të përcillet me probleme edhe në pranimin e kuadrove të reja. Me vitin akademik 2010/2011 pothuajse ka përfunduar mbrojtja e temave të doktoratës të paraqitura më herët. Në ndërkohë, në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, është evidentuar kërkesë në rritje për studime të doktoratës në të gjitha fushat e në këtë kuadër edhe në Ekonomi.

Nisur nga kjo situatë, Fakulteti Ekonomik propozon program studimi të doktoratës në drejtimet:

- **Banka, Financa dhe Kontabilitetet**
- **Menaxhment dhe Informatikë**
- **Marketing**
- **Ekonomiks**

Me programet e studimeve të nivelit të doktoratës synohet që të zgjerohen njohuritë, shkathhtësitë dhe të bëhet progres nga niveli i të mësuarit për shkencën në nivelin për ushtrimin e shkencës përkatësisht zbatimin e hapave të metodologjisë së hulumtimit shkencor, identifikimin e problemit për hulumtim, formulimin e hipotezës, planifikimin e hulumtimit, mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe prezantimin e tyre.

Programet e studimeve të doktoratës të propozuara nga Fakulteti Ekonomik janë në pajtim me dokumentet strategjike të rrjetit të institucioneve të arsimit të lartë në nivel të Procesit të Bolonjës si dhe të strategjisë zhvillimore të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës dhe Programit Kombëtar të Shkencës në Republikën e Kosovës.

Ky aplikim, mbështetet edhe në dokumentin për akreditimin e studimeve master, përkatësisht të studimeve bachelor dhe master nga e njëjta fushë shkencore si dhe të studimeve bachelor dhe master në fushat e studimeve përkatëse ndërdisiplinore.

Programet janë përgatitur në frymën e dokumenteve strategjike për financimin e arsimit të lartë, autonomisë financiare dhe menaxheriale të Universitetit të Prishtinës, rregullores së studimeve të doktoratës me të gjitha anekset e saj si dhe në frymën e realizimit së bashku me programin e studimeve bachelor dhe master.

Në hartimin e këtyre programeve të studimit kanë marrë pjesë profesorët e të gjitha konsultuar kolegë dhe hulumtues jashtë departamenteve.

Në Universitetin e Prishtinës, aktualisht nuk ka studime të ngjashme të doktoratës dhe studimet e propozuara pritet të nxisin zhvillimin e arsimit të lartë dhe shkencës në rend të parë, por edhe zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Kosovës në përgjithësi duke marrë për bazë rëndësinë që kanë studimet e

propozuara të doktoratës për krijimin e dijeve ose të praktikave të reja dhe relevante për synimet strategjike zhvillimore.

Qëndrueshmëria e ofrimit të programeve të studimit të doktoratës bazohet në numrin e kontratave për punë të lidhura me personelin shkencor – mësimor të zgjedhur me normë të plotë në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, por edhe me pjesëmarrjen e një numri të orëve për programet e propozuara të studimeve do ta realizojnë të punësuarit me orar të plotë të punës me titull të lartë shkencor – mësimor. Raporti ndërmjet numrit të përgjithshëm të të punësuarve dhe numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar do të jetë në përputhje me rregulloren e studimeve të doktoratës së UP-së.

Në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe rregulloren e studimeve të doktoratës në UP, studimet e doktoratës do të zgjasin tre vjet (180 ECTS kredi). Fakulteti Ekonomik, ka propozuar lëndët zgjedhore (më poshtë në dokument) dhe në përputhje me rregulloren e UP, nuk ka lëndë obligative. Studimet e doktoratës përfundojnë duke fituar gradën “doktor i shkencave të ekonomisë” ndërsa diploma do të jetë në përputhje me UA për formën dhe përmbajtjen e diplomës të lëshuar nga MASHT. Numrin më të vogël dhe më të madh të doktorantëve potencialë për një vit akademik e propozojnë departamentet dhe e miraton Këshilli i Fakultetit Ekonomik në përputhje me rregulloren dhe bëhet njoftim publik. Parakushtet për regjistrim/pranim duhet të publikohen dhe duhet të jenë në përputhje me rregulloret në fuqi duke i kushtuar vëmendje për të definuar kushtet e regjistrimit në studim për kandidatët të cilët i kanë marrë kualifikimet më herët (para Bolonjës). Në këtë kuadër, kriteret duhet të mbështeten në rregulloren e UP.

Plani dhe programi i studimeve të doktoratës i përgjigjet strukturës së programit të studimeve të doktoratës të paraparë me rregulloren e studimeve të doktoratës të aprovuar nga UP dhe bazohet në krijimtarinë shkencore në njohuritë, dituritë dhe shkathtësitë më të reja dhe është i krahasueshëm me programet e ngjashme të doktoratës të universiteteve të jashtme me renome, veçanërisht të atyre nga shtetet e Bashkimit Evropian. Është i krahasueshëm veçmas në përshkrimin e mënyrës së aftësisimit të doktorantëve të cilat do t’u mundësojnë që problemet e ndërlikuara shoqërore dhe ekonomike t’i zgjidhin në mënyrë kreative dhe bazuar në hulumtimet shkencore duke synuar aftësimin që në mënyrë të pavarur, hulumtuese dhe ndërdisiplinore t’i qasen problemeve, të hulumtojnë në mënyrë të pavarur dhe që në mënyrë kritike ta vlerësojnë punën e të tjerëve.

Përshkrimi i sistemit të këshillimit dhe të drejtimit (udhëheqjes) të doktorantit gjatë studimeve të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e doktorantit, të mentorit dhe të bartësit (institucionit përgjegjës) të studimeve do të jetë në korniza të rregullores së UP. Përshkrimi i mënyrës së pjesëmarrjes së doktorantëve në procedurat e vlerësimit të programit të studimeve të doktoratës, përcjelljen e efikasitetit të zhvillimit (zbatimit) të programit të studimeve të doktoratës (procedurat e vlerësimit dhe të vetëvlerësimit – vetëvlerësimi vjetor i programit të studimeve, vetëvlerësimi vjetor i doktorantit, rishikimi dhe avancimi i studimeve të doktoratës në pajtim me rezultatet e përcjelljes së cilësisë dhe të rezultateve të vetëvlerësimit të pjesëmarrësve të programit të doktoratës), po ashtu do të jenë të rregulluara me rregullore të studimeve të doktoratës në nivel të UP apo të njësive akademike.

Qëllimet e studimeve të doktoratës

Qëllimet e studimeve të doktoratës janë:

1. krijimi i diturive, njohurive dhe praktikave të reja dhe relevante, si dhe zbatimi i tyre;
2. arsimimi i hulumtuesve dhe i studiuesve të dalluar në fusha të caktuara ekonomike;
3. aftësimi i doktorantëve për punë të pavarur kërkimore, për hulumtime të pavarura dhe për vlerësime kritike të punës së të tjerëve.
4. arritja e diturive, përvojave dhe shkathtësive, të cilat duhet t'u mundësojnë doktorëve të shkencave që në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime t'i zgjedhin problemet komplekse ekonomike;
5. ndërkombëtarizimi i punës kërkimore në Universitet.

Mësimi dhe hulumtimi në studimet e doktoratës

- (1) Komponenti thelbësor i studimeve universitare të doktoratës është kërkimi dhe krijimi shkencor.
- (2) Format e punës në studimet e doktoratës janë seminarët kërkimore, punëtoritë dhe grupet e diskutimit, me qëllim të zhvillimit të punës kërkimore, mendimit kritik, përvetësimit të metodologjisë dhe shkathtësive të përgjithshme.
- (3) Mësimi në formë të ligjëratave nuk bën të kalojë 20 për qind të ngarkesës së përgjithshme të paraparë me programin e studimeve dhe të llogaritur sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve (ECTS).
- (4) Sipas mundësive dhe në bazë të kushteve të përcaktuara paraprakisht, ndjekja e mësimave në studimet e doktoratës është e hapur për të gjithë doktorantët e Universitetit.
- (5) Me qëllim të arritjes së inter-disiplinaritetit dhe në bazë të arsyeshmërisë dhe pëlqimit të mentorit, si dhe të pëlqimit të këshillit të studimeve të doktoratës, doktorantët mund të kryejnë pjesë të caktuara të kërkimit edhe në njësitë e tjera akademike të Universitetit ose në institucione të tjera përkatëse brenda dhe jashtë vendit.
- (6) Këshilli i studimeve të doktoratës mund t'u caktojë doktorantëve lëndë plotësuese për arritjen e diturive themelore, të domosdoshme për vijimin dhe përfundimin e studimeve.

Fazat e studimeve të doktoratës

Studimet e doktoratës organizohen në gjashtë semestra:

1. Në semestrin e parë studenti grumbullon 30 kredi ECTS nga seminarët e tri lëndëve të grup lëndëve të studimeve të regjistruara.
2. Në semestrin e dytë studenti grumbullon 30 kredi ECTS nga provimet e tri lëndëve profesionale nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar.
3. Në semestrin e tretë studenti grumbullon 30 kredi ECTS pas ratifikimit të projekt-propozimit të doktoratës dhe emërimit të mentorit nga Senati i Universitetit.
4. Në semestrin e katërt studenti grumbullon 30 kredi ECTS pas publikimit të një pjese të rezultateve të doktoratës në një revistë me recension ndërkombëtar nga lëmi përkatës me faktor impakti (IF).
5. Në semestrin e pestë dhe të gjashtë studenti grumbullon 60 kredi ECTS me rastin e mbrojtjes publike të punimit të doktoratës.

Struktura dhe organizimi i studimeve të doktoratës në Fakultetin Ekonomik

Departamenti Banka, financa dhe kontabilitet

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e parë

Në semestrin e parë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **provimet e tri lëndëve profesionale** nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Hulumtimet në kontabilitet: Mjetet dhe strategjitë
Strategjia e taksave dhe korporatave
Krizat financiare dhe ekonomike botërore

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

HULUMTIMET NË KONTABILITET: MJETET DHE STRATEGJITË– Përmbajtja e shkurtër: Hyrje në hulumtimet profesionale, Të menduarit kritik dhe aftësitë efektive për të shkruar si kontabilist profesionist, Mjedisi i Kërkimeve Kontabilitet, Mjetet hulumtuese në Kontabilitetin Financiar, Mjedisi i Kërkimeve Ndërkombëtare, Bazat tjera të të dhënave, Kërkimet tatimore për planifikimin e taksave. Shërbimet e sigurimit dhe Hulumtimet në auditimit, Rafinimi i procesit të hulumtimeve, Teknikat e hulumtimit të mashtrimit dhe teknika të tjera hetimore.

Literatura: Accounting Research: Tools and Strategies, 7th Edition, Thomas R. Weirich (Central Michigan University), Thomas C. Pearson (University of Hawaii at Manoa), Natalie Tatiana Churyk (Northern Illinois University) October 2009, ©2010.

STRATEGJIA E TAKSAVE DHE KORPORATAVE – përqendrohet në rëndësinë e tatimeve gjaët procesit të vendimmarrjes në biznese. Përmbajtja e shkurtër e lëndës është: Tatimet e korporatave, Tatimet eksplicite dhe implicite, Kostot jo tatimore dhe impakti i pasigurive, kontabiliteti financiar dhe tatimet në fitim, Mjetet e investimit dhe kursimeve, tregu i parave, anuitetet dhe pensionet, Bashkimi dhe fuzionomi i korporatave, Planifikimi i kompensimeve, Kontrolli dhe qeverisja e korporatave.

Literatura: Brealey, Meyers: Principles of Corporate Finance, Mc-Graw Hill 2001, Financat e korporatave, G. Luboteni, Prishtinë, 2007.

KRIZAT FINANCIARE DHE EKONOMIKE BOTËRORE – Teoritë për krizat financiare dhe ekonomike, Llojet e krizave financiare dhe ekonomike, Historia e krizave financiare dhe ekonomike, Shkaqet dhe pasojat e krizave ekonomike dhe financiare, Kriza ekonomike dhe integrimi regional dhe global, Efektet e krizës financiare në ekonominë globale, Kriza e borxheve sovraane, Efektet negative të krizës së borxheve në Eurozonë, Kriza globale financiare aktuale 2008 – 2011.

Literatura: Keneth Rogoff: Will the IMF stand up to Europe, Harold James: Economic crisis and regional integration, Paul Krugman: The return of depression economics and the crisis of 2008.

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e dytë

Në semestrin e dytë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **seminaret e tri lëndëve të grup lëndëve të studimeve të regjistruara**. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Inxhinieringu financiar dhe menaxhimi i riskut të kredive
Teoritë e avancuara të kontabilitetit
Metodat empirike në kontabilitet dhe financa
Menaxhimi i kostos i avansuar
Analiza financiare, planifikimi dhe parashikimi
Investimet dhe financat ndërkombëtare

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

INXHINIERINGU FINANCIAR DHE MENAXHIMI I RISKUT TË KREDIVE – Çfarë është inxhinieringu financiar, Principet e shkëmbimit, Arbitrazha dinamike, Opcionet e mbrojtjes (helsing), Prezantim i menaxhimit të riskut, Modelet strukturore të menaxhimit të riskut kreditor, Aplikimi i modeleve strukturore, Sjellja e paqëndrueshmërie, Sfidat kreditore në menaxhimin e riskut, Qasja tradicionale në menaxhimin e riskut të kredive, Prezantim i VaR, Qasja e porforlios së kredive, Modelet e testimit të stresit të riskut të kredive, Aplikimi i risqeve jo tregtare, Menaxhimi i derivateve të riskut.

TEORITË E AVANCUARA TË KONTABILITETIT – Qasja tradicionale dhe qasja e re në teorinë e kontabilitetit, kontabiliteti financiar, kontabiliteti i kostos, kontabiliteti menaxhmentit, konceptet dhe metodat e pasqyrave financiare, raportimi financiar, analiza e pasqyrave financiare, analiza e pikëthyerjes, profitabiliteti, standardet e kontabilitetit, kontabiliteti ndërkombëtar dhe BE.

METODAT EMPIRIKE NË KONTABILITET DHE FINANCA - Ky kurs ka për qëllim pajisjen e studentëve me aftësi të vëna për të dizajnuar dhe kryer studimet empirike bazuar në të dhënat vëzhgimore në fushën e kontabilitetit dhe financave. Pas përfundimit me sukses të kursit studentët duhet të kuptojnë bazat dhe grackat e zakonshme kuazi-eksperimentale të kërkimeve, të jenë të afërt me mekanizmat e përputhjes, variablat instrumentale dhe të dhënat tjera që ndikojnë në marrjen e vendimeve. Kjo mund të arrihet përmes përdorimit të pakove softuerike STATA dhe / ose SAS, duke mbledhur përvojat në hartimin dhe kryerjen e projekteve në shkallë të gjerë kërkimore. Format i kursit: Kursi përbëhet nga një kombinim i leksioneve, ushtrimet praktike, dhe prezantimeve të në formë të seminareve.

MENAXHIMI I AVANCUAR I KOSTOS – shtjellon vendimmarrjen menaxheriale në aspektin teorik dhe praktik, në nivele të ndryshme menaxhuese, kryesisht për bizneset fitimprurëse. Përmbajtja e shkurtër e lëndës është: Koncepti i menaxhimit të kostos, Menaxhimi i kostos dhe strategjia, Procesi i kostos dhe alokimi i kostos, kontrolli operacional, Kontrolli menaxherial, Qasja e përparuar e menaxhimit të kostos, Menaxhimi bashkëkohor i kostos, Planifikimi menaxherial dhe marrja e vendimeve, Produkti dhe kosto e shërbimeve, Matja e produktivitetit dhe kontrolli, Kostot e mjedisit dhe kontrolli.

Literatura: Cost management: A strategjia Emphasis, E. Stoun, E. Blocher, D. Stout, G. Cokins, 13 th Edition 2009. Advanced cost and management accounting, R. Jayaprakash.

ANALIZA FINANCIARE, PLANIFIKIMI DHE PARASHIKIMI - Ky kurs u ofron studentëve tema të avancuara kërkimore në lidhje me planifikimin e menaxhimit financiar, parashikimin dhe marrjen e vendimeve. Studentët eksplorojnë temat e analizës ekonometrike dhe analiza kohore serike, rrjedhës së parasë, inventarit, zinxhirët e furnizimit, parashikimit të shitjes dhe modelimin e planifikimit financiar afat shkurtër dhe afatgjatë gjatë. Studentët identifikojnë tema potenciale kërkimore për disertacionin e tyre dhe eksplorojnë dimensionet ligjore, etike, dhe globale të parashikimit dhe planifikimit parashikimit dhe analizave financiare.

INVESTIMET DHE FINANCAT NDËRKOMBËTARE - Me globalizimin e ekonomisë botërore, integrimin e tregjeve financiare përtej kufijve, dhe paraprakisht në teknologji, korporatat multi-nacionale po përballen me sfida në rritje në menaxhimin e operacioneve të tyre dhe financat në nivel global. Ky kurs do të sigurojë menaxherëve ndërkombëtar me mjetet e nevojshme për të vlerësuar rreziqet e mjedisit ekonomik ata veprojnë dhe për të bërë operacion globale dhe vendimet për investime. Ky kurs ka tre pjesë. Pjesa e parë mbulon strukturën bazë të tregjeve valutore, faktorët që ndikojnë në normat e jashtme të shkëmbimeve dhe marrëdhëniet midis normave të këmbimit dhe normat e interesit. Pjesa e dytë mbulon kornizën analitike për vlerësimin e ekspozimeve të ndryshme në një korporatë. Ajo gjithashtu

ofron një diskutim të hollësishëm për instrumentet financiare siç janë: borxhi në valutë të huaj dhe këmbime të monedhës që mund të përdoren për të zbutur ose plotësisht eliminohen rreziqet e këmbimit valutor. Pjesa e fundit e kursit mbulon vlerësimin e kostos së kapitalit në valutë vendore apo të huaj si dhe koston përkatëse të kapitalit për marrjen e vendimeve të tilla si investimet globale, shkrirjen dhe bashkimin apo edhe zhvendosjen e objekteve të prodhimit. Ajo gjithashtu prek disa trajtime themelore të kontabilitetit për investimet e huaja. Në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të analizojnë se si vepron një korporatë multi-nacionale në këmbimin valutor, të bëjë rekomandimet e duhura se si të zbuten rreziqet, dhe të krahasojnë mundësitë e investimeve nga një perspektivë globale.

Literatura: International Financial Economics – Corporate Decisions in Global Markets, by Thomas J. O'Brien, 2nd Edition.

Departamenti Menaxhment dhe Informatikë

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e parë

Në semestrin e parë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **provimet e tri lëndëve profesionale** nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Menaxhimi strategjik i resurseve humane
Modelet bashkëkohore të qeverisjes afariste
Qasje të reja të menaxhmentit

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

MENAXHIMI STRATEGJIK I RESURSEVE HUMANE – Qëllimi i këtij kursi është që studenti ët zhvillojë aftësinë që në mënyrë strategjike të mendojë organizatën ti ofrohet një qasje drejt aftësive konkurruese të qëndrueshme duke u bazuar në strategjinë afariste. Përmbajtja e shkurtër e lëndës është: MSRNJ – qëllimet e studimit, Kuptimi i strategjisë së resurseve njerëzore, Qëllimi i menaxhimit strategjik të RNJ, Strategjitë e menaxhimit të RNJ, Nevoja për RNJ sipas llojeve të strategjive, Implikimi i strategjive të ndryshme në funksionet e RNJ, Metodat e vlerësimit të të MSRNJ.

Literatura: John Bratton, Jeffrey Gold: Strategic human resurse management, 2007, Randall S, Susan E. Jackson: Human resoruse management, 2007.

MODELET BASHKËKOHORE TË QEVERISJES AFARISTE – kanë të bëjnë me vendimmarrjen menaxheriale dhe rolin e saj në të menduarit strategjik. Aftësia për të marrë vendime më të mira menaxheriale ofron një avantazh gjatë gjithë jetës profesionale konkurruese të firmave. Principet e vendimmarrjes do të aplikohen në kurset e mendimit strategjik duke rezultuar me një avantazh në të gjitha fushat e jetës. Përmbajtja e shkurtër e lëndës: Modelet dhe realitetet vendimmarrëse menaxheriale,

Inkuadrim i vendimit, Gjykimet e njeriut, deduksioni dhe paragjykimi, Emocionet dhe intuïta, Stilet vendimmarrëse individuale, Kreativiteti dhe proceset e vendimeve grupore.

Literatura: Drucker P.F: The effective decision, Harvard Business School, Janis I.L & L. Mann: Decision making strategies.

QASJE TË REJA NË MENAXHMENT – përmban: Qasja klasike (menaxhmenti shkencor, menaxhmenti administrativ), qasja bihervioristike (shkencat bihervioristike, vlerësimi i qasjes bihervioristike), qasja kuantitative (qasja shkencore matematikore, menaxhmenti operacional, vlerësimi i qasjes kuantitative), qasja sistemore (sistemet e hapura, sistemet e mbyllura, sinergjia dhe entropia), qasja situatave (qasja universale, qasja situacionale).

Literatura: R. Griffin: Management, second edition, New York 2003, Ramosaj B: Menaxhmenti kreativ dhe lidershipi, Vatra Prishtinë 2006. Samuel C. Certo: Modern management, Prentice Hall, 2003.

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e dytë

Në semestrin e dytë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **seminaret e tri lëndëve të grup lëndëve të studimeve të regjistruara**. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Sistemi informatik i menaxhmentit dhe strategjia menaxheriale
Mjedisi afarist (biznesi, qeveria dhe shoqëria)
Menaxhmenti financiar i avansuar
Analiza e sistemeve, dizajnimi dhe implementimi
Menaxhmenti i integruar i dijes me iniciativa strategjike
Ndërmarrësia dhe BVM-të

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

SISTEMI INFORMATIK I MEMAXHMENTIT DHE STRATEGJIA MENAXHERIALE – Menaxhimi i informacioneve dhe sistemi i kontrollit, sistemet informatike në krijimin e përparësive konkurruese, impaktet në transformimin e organizatës, IS teknikat e dizajnit dhe metodologjitë, menaxhimi i burimeve informatike, menaxhimi i funksionimit të IT në organizatë, llogaritja kontinuele, teknologjia e llogaritjes kontinuele, menaxhimi i fatkeqësive dhe marrja e masave, menaxhimi i vazhdimësisë së biznesit, standardet dhe rregulloret e menaxhimit të TI, burimet njerëzore në menaxhimin e TI.

MJEDISI AFARIST (BIZNESI, QEVERIA DHE SHOQËRIA) – Mjedisi biznesor, Qëndrime kundërthënëse në raportet: biznesi -qeveria – shoqëria, Tregu dhe qeveria, idealja dhe realiteti, mjedisi biznesor në vendet e ndryshme, përgjegjësia shoqërore korporatave, politika antimonopolistike, kartelet, monopolizimi, bashkimi dhe blerjet, politika qeveritare rregulluese, energjia, telekomunikacioni, transporti, etka profesionale, qeveria dhe mjedisi biznesor, përkrahja e qeverisë ndaj bizneseve.

MENAXHMENTI FINANCIAR I AVANCUAR – Buxheti i avancuar kapital dhe krijimi i vlerave, analiza e portfolios, struktura e avancuar e kapitalit dhe tatimimi vi dividendit, letrat e çmueshme tregtaree, kontraktimi financiar, çështje të investimeve, çështje të analizave të korporatave, qeverisja e korporatave, ankthi financiar dhe privatizimi i ndërmarrjeve të falimentuara, mbrojtja e korporatave dhe menaxhimi i riskut, çështje të përkohshme të menaxhmentit financiar.

ANALIZA E SISTEMEVE, DIZAJNIMI DHE IMPLEMENTIMI - Ky kurs studion analizën, projektimin dhe zhvillimin e sistemet e informacionit të bazuar në kompjuter. Karakteristikat kryesore të metodologjisë së orientuar kah objekti janë metodat e prezantuara dhe të krahasuara me ato tradicionale. Studentët do të njoftohen me konceptin e ciklit jetësor dhe aktiviteteve të lidhura duke përfshirë kërkesat për përcaktimin e informacionit, sistemet e detajuara për projektimin, zhvillimin, testimin dhe strategjitë e zbatimit.

MENAXHMENTI I INTEGRUAR I DIJES ME INICIATIVA STRATEGJIKE - Kursi ofron një mundësi për të shqyrtuar iniciativa të mëdha organizative dhe për të përcaktuar se si menaxhimi i njohurive (KM) mund të përdoret për të leverazhuar këto nisma. Theksi është vendosur në KM, si një pjesë integrale dhe thelbësore e një sistemi organizativ në nivel operativ dhe strategjik. Faktorë të tillë si të cilësisë, sistemet e të menduarit, skanimit të mjedisit, konvergjencave dhe konfliktit konstruktiv janë theksuar si kontribuues thelbësor në integrimin e KM në planifikimin, vendim-marrjen dhe zbatimin e iniciativave operative dhe strategjike. Elementet e sistemit Embedde si lidhshipi dhe kultura korporative janë trajtuar gjithashtu. Kjo, sepse miratimi i një nisme të KM mund të kërkojë ndryshime strukturore dhe ambientaliste, për të fituar pranimin organizativ, mënyra këto për të anashkaluar pengesat për adresuar ndryshimet e nevojshme.

NDËRMARRËSIA DHE BVM-ve - BVM-të dhe ekonomia nacionale (kombëtare); Ekonomiksi i firmave të vogla; Ndërmarrësit e Bizneseve të Vogla dhe menaxherët; Mundësia, Inovacioni dhe Ndërmarrësia; Ndërmarrësia Teknologjike; Biznesi familjar; Strategjitë për sukses; Ciklet e jetës dhe të Portfolios; Financimi i BVM-ve; Plani i Biznesit; Strategjitë e Marketingut për BVM-të; Dalja; Ndërmarrësia Sociale; Institucionet dhe Ndërmarrësia (Zhvillimi i Ndërmarrësisë në Kosovë).

Literatura: David Stokes & Nick Wilson: Small Business Management and Entrepreneurship, 6th edition, 2010, Justin Longenecker, Carlos Moore, J. William Petty, Leslie Palich: Small Business Management - An Entrepreneurial Emphasis, 14th Edition, 2007, Paul Burns: Entrepreneurship and Small Business, 2nd Edition, Palgrave Macmillan, 2007, Mathias Fink & Sascha Kraus: The management of Small and Medium Enterprises, Routledge Studies in Small Business, 2009, Artikuj shkencorë dhe përdorimi i letrave për të diskutuar rreth rasteve studimore.

Departamenti i Marketingut

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e parë

Në semestrin e parë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **provimet e tri lëndëve profesionale** nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Menaxhimi i avansuar i marketingut
Menaxhimi i zhvillimit të produkteve
Menaxhimi i strategjive të e-marketingut

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

MENAXHIMI I AVANCUAR I MARKETINGUT – Nocioni dhe kuptimi i MAM, Mjedisi dhe sistemi informatik i marketingut, Menaxhimi i kënaqësisë dhe lojalitetit të konsumatërove, Segmentimi dhe pozicionimi i produkteve në treg, Modeli i strategjive të marketingut të avancuar, Formulimi, implementimi dhe evaluimi i strategjive të marketingut, Plani i marketingut aksionar – 4P.

Literatura: Philip Kotler & Kelvin Keller: Marketing management, 12 th edition, 2010, Norton Paley: Competitive marketing strategies, 2008, Bardhyl Ceku: Menaxhimi i marketingut, Tiranë, 2010.

MENAXHIMI I ZHVILLIMIT TË PRODUKTEVE – Analiza e teorive dhe funksioneve të menaxhmentit, Funksionet e menaxhmentit dhe roli i tyre në avancimin e prodhimit, Menaxhimi produkteve të reja, Mundësitë e aplikimit të instrumenteve të marketingut mik, Roli i menaxhmentit strategjik në definimin e strategjive prodhuese, Menaxhimi i produkteve të reja dhe reformat në filozofinë afariste, Analiza ekonomike dhe plasimi i produkteve të reja në treg.

Literatura: B. Beqaj: Menaxhimi i zhvillimit të produkteve të reja në Kosovë, Prishtinë 2003, Rodger G. Schroeder: Operations management Contemporary Cases and Concepts, McGraw Hill, 2000.

MENAXHIMI I STRATEGJIVE TË E – MARKETINGUT – Marketingu elektronik ka pesë objektiva që synon ti arrin në mënyrë që ndërmarrja të ketë benefite shtesë: rritja e shitjeve, shtimi i vlerës së produktit, afrimi me konsumatorin, ruajtja e kostos, zgjerimi i tregut online. Të gjitha këto objektiva mund të përmbliohen si 5 S-të (Sell, Serve, Speak, Save dhe Sizzle. Përmbajtja e shkurtër e lëndës do të jetë: Nocioni dhe prezantimi i E-marketingut, Remix i E-marketingut, E-modelet dhe E-konsumatorët, Krijimi dhe dizajnimi i një WEB faqe, E- mediat, E- CRM dhe E-planifikimi.

Literatura: David Chaffey & PR Smith: E-marketing Excellence, 2010,

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e dytë

Në semestrin e dytë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **seminaret e tri lëndëve të grup lëndëve të studimeve të regjistruara**. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Menaxhimi i cilësisë dhe çmimeve
Biznes Marketingu
Modelet e sjelljes së konsumatorëve
Metodat kuantitative në marketing
Sistemi integral i komunikimit – promocionit – SIK
Teknologjia e marketingut

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

MENAXHIMI I ÇMIMIT DHE CILËSISË SË PRODUKTEVE – Objektivat dhe strategjitë e çmimit, Llojet e çmimeve, Strategjia e çmimeve sipas: vendndodhjes, mënyrës së pagesës, në bazë të situatave në treg, Çmimet promovuese, Çmimet diskriminuese, Çmimi u një game të produktit, Harmonizimi i objektivave të çmimit me ato të marketingut, Strategjitë e caktimit të çmimit, Strategjitë në raport cilësi / çmim, Caktimi i çmimeve në krahasim me konkurrencën, Reagimi i ndërmarrjeve ndaj modifikimit të çmimeve, Faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në caktimin e çmimit, ECK, Metoda e kostos plus fitimi, Metoda margjinale, Metoda e pikës kritike të rentabilitetit etj.

BIZNES MARKETINGU – Ky kurs ofron një qasje progresive për marketing të biznesit dhe të menaxhimit të tregut të biznesit, duke krijuar dhe dhënë vlera në tregjet e synuara të biznesit dhe konsumatorëve. Tregjet e biznesit janë të përbërë prej firmave, institucioneve ose qeverive. Kursi ofron një kuptim të nëntë proceseve të tregut të biznesit: ndjenjës së tregut dhe përcaktimin e vlerave, të kuptuarit e firmave dhe konsumatorëve; crafting strategjitë e tregut; ofertat menaxhimin e ofertave të tregut të bazuar në vlera të çmimeve; menaxhimin kanaleve të biznesit, konsumatorët e fituar, partneritetet të qëndrueshme, rishitësit dhe mbajtjen e marrëdhënieve me konsumatorët. Ky kurs ka zbatueshmërinë e fortë për studentët që kërkojnë të bëjnë karrierë në konsulencë menaxheriale dhe shërbime financiare, si dhe në fushën e marketingut dhe menaxhimin e përgjithshëm me teknologji e po ashtu edhe te firmat industriale.

MODELET E SJELLJES SË KONSUMATORËVE – Ky kurs bazohet në Marketing dhe në Menaxhimin e Marketingut. Ky kurs mbulon fushën e psikologjisë së konsumatorit dhe siguron një strukturë sistematike për të analizuar sjelljen e konsumatorëve nga pikëpamja e tregtarit. Fokusi është në gjenerimin e njohurive të konsumatorit si një bazë e nevojshme për zhvillimin e strategjive të

marketingut si dhe për përmirësimin e vendimeve të marketingut miks. Konceptet psikologjike në të, i bëjnë të mundur tregtarit për të bërë përdorimin më të mirë të hulumtimit të tregut. Kursi i drejtohet studentëve të përgatitur për menaxhimin e produktit, zhvillimin e biznesit, ose pozicionet këshilluese.

METODAT KUANTITATIVE NË MARKETING - Ky kurs bazohet në Analizat menaxheriale, Marketing dhe në Menaxhim të Marketingut. Objektivi i gjerë i këtij kursi është që të sigurojë një kuptim themelor të metodave të hulumtimit të marketingut të punësuar nga firma të mirë-menaxhuar. Kursi fokusohet në integrimin e formulimin e problemit, projektimin, kërkimin, ndërtimit të pyetësorit, marrjen e mostrave, mbledhjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave që japin informacione të vlefshme. Kursi gjithashtu shqyrton përdorimin e duhur të aplikacioneve statistikore si dhe metodat cilësore, me një theks të veçantë në interpretimin dhe përdorimin e rezultateve.

SISTEMI INTEGRAL I KOMUNIKIMIT – PROMOCIONIT (SIK) – Definimi i konceptit të SIK, Vendi i SIK në Marketing, Planifikimi i SIK, Modelet e formimit të buxhetit të SIK-ut, Audiencia e SIK-ut, Format kryesore të promocionit, Reklama dhe planifikimi i saj, Krijimi i reklamës audiovizuale, Procesi i shitjes personale, Marrëdhëniet me publikun dhe raporti i tyre, Koncepti i publicitetit ekonomik, Promocioni i shitjeve dhe ndikimi i tyre në pozicionimin e ndërmarrjes.

TEKNOLOGJIA E MARKETINGUT - Ky kurs ofron studentëve kornizat konceptuale dhe mjetet analitike për vendim të marketingut të bërë në bizneset e me rritje të lartë teknologjike. Kursi është ndër-funksional, i fokusuar në vendimmarrje dhe strategjik në orientimin e tij. Temat përfshijnë marketingun në ekonominë e rrjetit, të kuptuarit e nevojave të përdoruesit, standardet e teknologjisë dhe rrjetit, parashikimin e kërkesës dhe të planifikimit strategjik në tregjet e teknologjisë, dizajnimi dhe arkitektura e produktit etj.

Departamenti i Ekonomiksit

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e parë

Në semestrin e parë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **provimet e tri lëndëve profesionale** nga fusha e ngushtë e drejtimit të cilin e ka regjistruar. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Krahasimi i teorive ekonomike
Mikroekonomia e avancuar
Globalizimi i ekonomisë botërore

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

KRAHASIMI I TEORIVE EKONOMIKE – Mendimi i hershëm ekonomik, Shkollat e mendimit ekonomik prej shek.të mesëm deri në shek.20, Teoritë ekonomike të Smithit, Teoria bashkëkohore ekonomike, Teoritë ekonomike postkensiane Teoritë bashkëkohore mikroekonomike postmarshalliane, Teoritë e rritjes endogjene, Teoritë ekonomike të integritit rajonal, Qeverisja ekonomike globale, Teoritë e mirëqenies ekonomike.

Literatura: Robert Gilpin: Ekonomia politike globale, ISP 2000, Massimo Gaggi: Orteku dhe kriza amerikane te recesioni botëror, Morava, 2009, S. Selmanaj: Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë 1996.

MIKROEKONOMIA E AVANCUAR – do të avancojë njohuritë e studentëve nga fusha e teorive mikroekonomike. Fokusi do të jetë mbi analizën e preferencave dhe konceptin e dobisë si hyrje për shtjellimin e zgjedhjes konsumatore, teoria e kërkesës, inputet dhe funksioni i prodhimit, koncepti i koston dhe minimizimi i koston, analiza e strukturës së tregut dhe diskrimimit të çmimeve, teoria e lojërave, informatat asimetrike, etj.

Literatura: Mas-Colell, Whinston, & Green (MWG), 1995, Microeconomic Theory. Milgrom and Roberts (1992), Economics, Organization and Management. Fudenberg, D. and J. Tirole (1991), Game Theory, Cambridge: MIT Press. Laffont and D. Martimort, (2001), The Theory of Incentives, Princeton University Press.

GLOBALIZIMI I EKONOMISË BOTËRORE – Ekonomiksi i globalizimit, migracioni i fuqisë punëtore, Globalizimi dhe transicioni, Globalizimi dhe kapitali njerëzor, Globalizimi i kapitalit, Efekti i globalizimit në aftësinë konkurruese dhe në unifikimin e tregjeve, Globalizimi dhe diskrecioni i politikave nacionale.

Literatura: Bauer T & Zimmerman K.: assesment of possible migracion pressure and its labour market impakt following EU enlargement to Central and Eastern Europe, IZA Research Report 3 (1999), Belfied C: Economic principles of education: Theory and evidence.

Lëndët / Kurset e ofruara për semestrin e dytë

Në semestrin e dytë, studenti grumbullon 30 ECTS nga **seminaret e tri lëndëve të grup lëndëve të studimeve të regjistruara**. Numri i orëve / semestër për secilën lëndë / kurs është 30, ndërsa numri i ECTS për secilën lëndë / kurs është 10. Lëndët e ofruara janë:

Titulli i lëndës / kursit
Metodat ekonometrike
Ekonomiksi i zhvillimit të Kosovës
Ekonomiksi i integritit evropian
Statistikat aplikative – softuerët statistikorë
Ekonomiksi financiar: kontratat dhe ndërmjetësimi
Ekonomiksi i zhvillimit të biznesit

Përmbajtja e shkurtër e lëndëve:

METODAT EKONOMETRIKE - Prezantim i ekonometrisë së avancuar, natyra e analizës së regresionit, modeli i regresionit me dy variabla, regresioni klasik linear, modeli ekstensiv me dy variabla, analiza e regresionit me shumë zgjidhje, modeli i regresionit me variabël bedel, multikorelariteti, heteroskedasticiteti, autokorelacioni, termat e korelaritetit.

Literatura: Luke Douglas a. 2004: Multilevel modelin, Thousands oaks, CA: Sage publications, Kline Rex B. 2005: Principles and practice of struktural equations modelin, 2nd Edition, N.York.

EKONOMIKSI I ZHVILLIMIT TË KOSOVËS - Karakteristikat kyçe të ekonomisë së Kosovës (BPV- Bruto Produkti i Vendit •Të ardhurat kombëtare • indeksi i zhvillimit njerëzor• indeksi i varfërisë• Papunësia-tregu i punës• Inflacioni dhe çmimet, etj); Ndryshimet institucionale nga sistemi socialist në ekonomi të tregut- Privatizimi i pronës shoqërore dhe publike, Struktura qeverisëse, institucionet e reja dhe struktura e tyre; Disa nga faktorët e zhvillimit ekonomik të Kosovës (Faktori njeri- popullsia dhe burimet njerëzore, Resurset minerare të Kosovës, energjëtika, agrikultura, të tjera); Struktura ekonomike dhe perspektiva në të ardhmen; Financat dhe politika fiskale për zhvillim; Financat e jashtme, investimet dhe ndihma; Integrimet ndërkombëtare dhe organizatat, etj.

Literatura: Michael P.Todaro & Stephen C. Smith “Economic Development”, Pearson Addison Wesley;England, 2006; “Kosova – Strategjia e Zhvillimit Ekonomik” Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës & Oda Ekonomike e Kosovës, 2002; “Strategjia e Energjisë e Republikës të Kosovës për periudhën 2009 – 2018”; “Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013”- Ministria e Ekonomisë dhe Financave; “Bruto Prodhimi Vendor në Kosovë për vitet 2004 – 2009 etj.

EKONOMIKSI I INTEGRIMIT EVROPIAN – Background historik dhe institucional, Rekonstruimi evropian hap pas hapi, Metoda Monet, Evoluimi i institucioneve evropiane, Integrimi i tregut të mallrave, Eliminimi i barrierave tregtare: nga unioni doganor deri te akti unik evropian, Politikat konkurruese dhe abuzimi me tregun, Politikat konkurruese dhe ndihmat shtetërore, Integrimi monetar evropian, Integrimi i tregut financiar, Unioni monetar evropian.

Literatura: Ballabriga, F. C. and C. Martinez-Mongay (2005). Sustainability of EU public finances. Economic papers European Commission, Directorate general for economic and financial affairs, No. 225. 2. Blanchard, O. and F. Giavazzi (2001). Macroeconomic effects of regulation and deregulation in goods and labor markets. NBER Working papers No. 8120. 3. Buti, M., S. Eijffinger, et al. (2003). Revisiting the Stability and Growth Pact: Grand Design or Internal Adjustment? Economic Papers European Commission, Directorate General for Economic and Financial Affairs, No. 180.

STATISTIKAT APLIKATIVE – Ky kurs është një prezantim i statistikës së aplikuar dhe aplikimit të softuerëve statistikorë në analiza statistikore dhe lëmi tjera gjatë punës hulumtuese shkencore. Përmbajtja e shkurtër e kursit është: Të dhënat dhe variablat, Bar-grafi, stemplotet dhe dotplotet, Histogrami, frekuenca relative dhe frekuenca kumulative, Time plots, Distribucioni përshkrues, Mediana, Devijimi

standard, Efektet e transformimit linear, Korelacioni, Regresioni i katrorëve të vegjël, Probabiliteti dhe simulimi, Krahasimi i dy parametrave të popullimit.

Literatura: Luke Douglas a. 2004: Multilevel modelin, Thousands oaks, CA: Sage publications, Kline Rex B. 2005: Principles and practice of struktural equations modelin, 2nd Edition, N.York.

EKONOMIKSI FINANCIAR – KONTRATAT DHE NDËRMJETËSIMI – Në këtë kurs ne shqyrtojmë ndërmjetësimin financiar, kur bankat mund të ofrojnë depozita ose kontigjent të kredive kontraktuale “goditjet” makroekonomike. Po ashtu tregojnë se ndarja e rrezikut është efikas në rastet kur nuk ka kriza bankare. Në këtë rast, bankat do të ndryshojë një pjesë të rrezikut të depozituesve. Në të kundërtën, në rast të krizave bankare, depozituesit pranojnë kontrata jo kontigjente me shkallë të lartë rreziku ndërsa sipërmarrësit marrin kontrata të kredive që kërkojnë një rimbursim të lartë në kohë të mira dhe shumë pak në kohë të këqija. Gjithashtu ne do të prezantojmë rëndësinë e sektorit financiar në ndarjen e fondeve dhe burimeve tjera për përdorimin e tyre më të mirë në ekonomi. Kujtojmë se financat e drejtpërdrejta iu referohen kursimtarëve dhe huamarrësve që i takojnë direkt në tregjet financiare, ndërsa financat indirekte përfshijnë përdorimin e një ndërmjetësi financiar. Derisa tregjet e aksioneve dhe obligacioneve të luajnë një rol më të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në këtë ndarjen e fondeve, ne gjejmë se, në ekonominë e zhvilluara, financat indirekte janë shumë më të rëndësishme

EKONOMIKSI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT – Prezantim i zhvillimit ekonomik, Teoria e rritjes, Modeli neoklasik i rritjes ekonomike, Modeli i Solowit, Ekonomiksi i hapësirës dhe komunikimit, Koncepti i ekonomiksit të zhvillimit, Ekonomia e tregut të hapur dhe përcaktimi i outputeve, Përcaktimi i kërkesës agregate dhe ndikimi në biznes, Tregu i punës dhe pronës, Tregu i kapitalit financiar, Institucionet dhe shoqëria, Politikrat dhe vendimmarrja.¹

Semestri i tretë

Në këtë semestër, studenti grumbullon 30 ECTS pas ratifikimit të projekt propozimit të doktoraturës dhe emërimit të mentorit nga Senati i UP-së,

Semestri i katërt

Në këtë semestër studenti grumbullon 30 ECTS pas publikimit të një pjese të rezultateve të doktoraturës në një revistë me recension ndërkombëtar me impakt faktor (IF),

Semestri i pestë dhe i gjashtë

Në këtë semestër, studenti grumbullon 60 ECTS me rastin e mbrojtjes publike të punimit të doktoratës.

¹ Vërejtje: Kandidati zgjedhë seminare nga lëndët zgjedhore në bashkëpunim me mentorin potencial.